



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 50/5 prot.

Tiranë, më 3.2.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 20.1.2023, është njoftuar vendimi nr. 605, datë 21.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka) ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Armida Hamiti (Moçka)*”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), nr.*** prot., datë **.10.2017, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida *** Hamiti”.²

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore, të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale.

3. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çmon se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë [...].

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...] Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente, që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit [...].

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Deklasifikuar me Vendimin e KDZH-së nr. ***, datë **.10.2022. Me dy shkresat e autoritetit informues, datë **.4.2022, dhe datë **.11.2022, informohet Komisioni se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirje të subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues, në mungesë të evidentimit të ndonjë mangësie apo defekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, bazuar në pikën 5 të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që iu njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 605/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cënueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu nënshtruar juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.

9. Për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Kontrolli i pasurisë

10. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj

subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Po ashtu, Komisioneri Publik mban në konsideratë dhe jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili i shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit.

12. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës”, dorëzuar në ILDKPKI, datë 14.12.2011, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

13. Në deklaratën “Vetting”, pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë si vijon:

a. *Akti i marrjes së tokës në përdorim nr. regj akti ***, datë **.10.1994, me sip.5.000 m² (bashkëpronësi me familjen bujqësore, të përbërë nga 5 anëtarë), i paregjistruar në regjistrat publikë, ndodhur në fshatin ***, Vlorë. Pjesa zotëruese: 20%.*

b. *Akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë **.3.1993, me sipërfaqe 18.619 m² (bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë), fshati ***, Vlorë, i paregjistruar në regjistrat publikë, nga të cilat sipërfaqja prej 444 m² është shpronësuar me VKM nr. 482, datë 23.6.2010. Pjesa zotëruese 20%. Të ardhura nga shpronësimi i pronës me VKM nr. 482, datë 23.6.2010, për shkak të ndërtimit të autostradës Levan-Vlorë, në vlerë 710.400 lekë. Pjesa zotëruese: 20 %.*

c. *Apartament banimi me sipërfaqe 106 m² (plus 10 m² ambient i përbashkët) Vlorë, regjistruar në ZVRPP Vlorë me nr. pasurie ***, blerë me kontratën e porosisë, datë **.5.2011, dhe kontratën përfundimtare të shitjes nr. ** rep., nr.*** kol., datë **.9.2012. Vlera 50.000 euro, me të ardhura të siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011. Sqaroj: apartamenti është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës e përbërë nga 5 anëtarë. Pjesa zotëruese: 20%.*

d. *Të ardhura nga aktiviteti privat familjar bujqësor: vreshtari, ullishte, bujqësi, shpendari dhe blegtori (në bashkëpronësi të familjes bujqësore të përbërë nga 5 anëtarë) të krijuara prej vitit 1994 deri në vitin 2011. Vlera 53.000 euro. Pjesa zotëruese: 20%. Sqarim: nga shuma 53.000 euro është depozituar në bankat e nivelit të dytë shuma 50.000 euro, ndërsa, në datën **.12.2015, kontratat e depozitave janë mbyllur dhe transferuar në emër të prindit.*

e. *Të ardhura të përfituara nga depozitat bankare të shumës 50.000 euro, duke filluar prej datës **.8.2011 deri në datën **.12.2015 (data e mbylljes së depozitave), përkatësisht me kontratën e depozitës, datë **.8.2011, pranë *** Bank, në shumën 10.000 euro, kontratën e*

depozitës, datë **.12.2011, pranë *** Bank, në shumën 10.000 euro, kontratën e depozitës, datë **.11.2011, pranë *** Bank, në shumën 10.000 euro, kontratën e depozitës, datë **.8.2012, pranë *** Bank, në shumën 20.000 euro. Vlera e të ardhurave 60.633,733 lekë dhe 3.063,52 euro. Pjesa zotëruese: 20%. Sqarim: Depozitat e mësipërme për shumën 40.000 euro të depozituara pranë *** Bank dhe *** Bank, së bashku me interesat e krijuara, janë mbyllur dhe transferuar tek *** Bank. Për këtë shumë të transferuar është lidhur kontrata e depozitës, datë **.7.2015, ndërsa në datën **.12.2015, është bërë mbyllja dhe transferimi i interesave të përfituara nga këto depozita bankare, së bashku me shumën 50.000 euro, në emër të prindit.

f. Garazh, me sipërfaqe 23,04 m², regjistruar në ZVRPP Vlorë, me nr. pasurie ***, blerë me kontratën e shitjes nr.** rep., nr.*** kol., datë **.9.2012. Vlera 500.000 lekë, me të ardhura nga paga e punës dhe aktivitetit privat bujqësor të familjes bujqësore. Sqarim: garazhi është në bashkëpronësi të familjes bujqësore të origjinës, e përbërë nga 5 anëtarë. Pjesa zotëruese:20 %.

g. Automjet tip “Golf Volkswagen”, me numër shasio: ***, i blerë me kontratën e shitjes nr.**.12.2015 nga shtetasi francez ***.*** ..., me vlerë 1.450 euro. Kjo autoveturë është blerë me të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit³ “Peugeot”, me targa: ***, në vlerën 1.000 euro dhe pjesa tjetër me të ardhura nga paga. Pjesa zotëruese: 100%. Vlera 1.450 euro.

13.1 Në Deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 14.12.2011, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar:

(i) Akti i marrjes së tokës në përdorim, nr. regj akti ***, datë **.10.1994, bashkëpronësi, 5.000 m², ***. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

(ii) Akti i marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë **.3.1993, me sipërfaqe 18.619 m², bashkëpronësi, 18.619 m², ***. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

(iii) Shpronësim nga rruga Levan-Vlorë. Vlera 710.000 lekë të reja. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

(iv) Apartament banimi, kontrata e porosisë datë **.5.2011, 116 m², Lagjja “***”, Vlorë. Vlera 50.000 euro. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit dhe pjesën takuese.

13.2 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti, përveç të ardhurave nga paga në Shkollën e Magjistraturës, ka deklaruar: të ardhura nga aktivitet privat i familjes bujqësore, ullishte, vreshtari, bujqësi, në vlerën 53.000 euro. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

13.3 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: (i) Më datë **.9.2012, Kontratë shitje për blerje garazh, nr. rep.** , nr. kol ***, sipërfaqe 23,4 m², me të ardhura nga puna dhe aktivitet privat. Vlera 500.000 lekë; (ii) Më datë **.12.2012, Blerje automjeti tip “Peugeot” (viti 2000) nga shtetasja ***.***, banuese në Fier, me të ardhura nga puna. Vlera 100.000 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

³ Automjet i cili është blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.2012, në vlerën 100.000 lekë, me të ardhura nga paga. Pjesa zotëruese 100%. Shitur me kontratë shitje nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.2.2016, me vlerë 3.000 euro.

13.4 Në deklaratat periodike vjetore 2012-2015, subjekti në rubrikën: “*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtarinë publike dhe/ose private*”, ka deklaruar interesat e përfituara nga depozitat bankare për secilin vit, si dhe, në DV-2015, veprimet e kryera për mbylljen e depozitave dhe transferimin e tyre në *** Bank, në emrin e nënës së subjektit, znj. ***.***.

13.5 Referuar këtyre deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, rezulton se në total pasuria e deklaruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në momentin e deklarimit fillestar të datës 14.12.2011, është në vlerën 103.000 euro, nga të cilat 53.000 euro janë deklaruar në formën e të ardhurave nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, dhe 50.000 euro është vlera e apartamentit të blerë në qytetin e Vlorës.

13.6 Nga përmbajtja e vendimit dhe aktet e administruara, Komisioni ka hetuar lidhur me burimin e deklaruar të këtyre pasurive, nga ku ka rezultuar si vijon:

13.6.1 (i) Lidhur me pasurinë apartament 106 m², Vlorë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar⁴, ka rezultuar se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e porosisë, datë **.5.2011, dhe kontrata përfundimtare e shitjes nr. ** rep., nr. *** kol., datë **.9.2012, me palë shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., dhe subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Moçka.

13.6.2 Çmimi i shitjes sipas kontratës është dakordësuar në vlerën 6.800.000 lekë ose ekuivalenti i saj 50.000 euro. Sipas përmbajtjes së kontratës, vlera e plotë e çmimit të shitjes është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

13.6.3 Komisionit, nga verifikimi i të dhënave bankare,⁵ i ka rezultuar se nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit në *** Bank (më parë ***), janë paguar nëpërmjet transfertave bankare 40.000 euro, në favor të shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., përkatësisht 10.000 euro në datën **.5.2011; 10.000 euro në datën **.5.2011; 10.000 euro në datën **.8.2011 dhe 10.000 euro në datën **.8.2011, secila me të njëjtin përshkrim: “*Transfer ***. sh.p.k., pagesë për blerje apartamenti nga Armida Moçka*”. Nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank (më parë ***), rezulton se vlerat e transferuara shoqërisë janë depozituar cash në llogarinë e subjektit, në 4 (katër) data⁶ të ndryshme, respektivisht nga 10.000 euro, me përshkrimin: “*dhuratë nga babai për blerje shtëpie*”.

13.6.4 Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar⁷ se një prej kësteve është paguar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet depozitimit cash në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., vlera 10.000 euro, në datën **.8.2011, me përshkrimin: “*pagesë për blerje apartamenti*”. Subjekti ka vënë në dispozicion të hetimit dhe lëvizjet e llogarisë së shoqërisë, nga ku konfirmohet sa ka deklaruar.

13.6.5 Komisioni, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në D-Vett. se kjo pasuri është blerë më të ardhura të siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011, i ka kërkuar⁸ subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues për të provuar

⁴ Referuar dokumentacionit në dosjen e ILDKPKI-së/aneks 29. ZQRPP, me shkresën nr. *** prot., dt. **.9.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP Vlorë.

⁵ Referuar shkresës nr. prot.***, datë **.7.2022, nga *** Bank.

⁶ Respektivisht në datat **.5.2011; **.5.2011; **.8.2011; **.8.2011.

⁷ Referuar përgjigjeve të Pyetësorit nr. 2, datë 28.10.2022.

⁸ Referuar Pyetësorit nr. 2, datë 28.10.2022.

ligjshmërinë e të ardhurave nga aktiviteti bujqësor i familjes, si dhe të sqarojë lidhur me mënyrën e mbajtjes, administrimit dhe shpërndarjes së këtyre të ardhurave.

13.6.6 Subjekti, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, ka depozituar dokumentacionin përkatës⁹, ndër të tjera, dhe vlerësimin e bërë në raportin e vlerësimit ekonomiko-bujqësor, nga Njësia Administrative Novoselë - Bashkia Vlorë.

⁹ Akti i marrjes së tokës në përdorim, nr. regj aktit ***, datë **.10.1994, me sipërfaqe 5000 m² (bashkëpronësi me familjen bujqësore, të përbërë nga 5 anëtarë), i paregjistruar në regjistrat publikë, e ndodhur në fshatin ***, Bashkia Vlorë, 1 faqe; Akti i marrjes së tokës në pronësi, nr. *** datë **.3.1993, prej të cilës janë regjistruar në regjistrat publikë, ngastrat e poshtëshënuara, 1faqe; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, “Arë”, data e regjistrimit: **.7.2018, nr. i pasurisë: ***, 2 faqe; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, “Arë”, data e regjistrimit: **.7.2018, nr. i pasurisë: ***, 2 faqe; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, “Arë”, data e regjistrimit: **.7.2022, nr. i pasurisë: ***, 3 faqe; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, “Arë”, data e regjistrimit: **.3.2016, nr. i pasurisë: ***, 4 faqe; një kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, “Arë”, data e regjistrimit: **.7.2019, nr. i pasurisë: ***, 2 faqe; vërtetim për të vetëpunësuar në bujqësi në emër të ***, **, lëshuar nga ISSH, Vlorë, 3 faqe; një kopje e librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të derdhura në emër të ***, **, 4 faqe; një kopje e vërtetimit nr. *** prot., datë **.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Novoselë, Drejtoria e Tatim - Taksave, nga e cila rezulton se fermeri ***, ***, nuk ka detyrime për tokën bujqësore, 1 faqe; vërtetim nr. *** prot., datë **.6.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, me të cilin provohet fakti se fermeri ***, ***, ka në pronësi 270 rrënjë ullinj, 1faqe; vërtetim nr. *** prot., datë **.7.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, ku provohet se fermeri ***, ***, tokën që ka në pronësi dhe përdorim e ka punuar gjithë kohës dhe ka paguar rregullisht detyrimet për tokën, 1 faqe; vërtetim nr. prot., datë **.9.2020, lëshuar nga Kryesia e Fshatit ***, Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, ku provohet se fermeri ***, ***, ka në pronësi 270 rrënjë ullinj, 1 faqe; një kopje e certifikatës së regjistrimit të fermerit ***, ***, 1 faqe; një kopje e të dhënave të printuara nga sistemi Ruda – Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar, pranë Drejtorisë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, ku provohet se fermeri ***, ***, është marrë me veprimtarinë e mbarëshimit të gjedhëve, 3 faqe; shkresë me nr. *** prot., datë **.7.2020, me lëndë: “Informacion” drejtuar shtetasit ***, **, lëshuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Bashkia Vlorë, mbi vlerësimin e prodhimit mesatar për kultivarin kalinjot dhe kultivarin frantoit, 1 faqe; vërtetim me nr. *** prot., datë **.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, me të cilin vërtetohet se, për periudhën kohore 1993 – 2010, nuk rezulton të ketë regjistër për numrin e krerëve të gjedhëve të familjeve bujqësore. Ky regjistër në Qarkun e Vlorës ka filluar të funksionojë pas vitit 2011, 1 faqe; vërtetim nr. *** prot., datë **.7.2020, mbi numrin e ullinjve që ka në pronësi fermeri ***, ***, 1 faqe; deklaratë noteriale, nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë **.8.2020, e veterinerit ***, ***, ku provohet se ka ofruar shërbimin veterinar për katër krerë lopë qumështi, të racës kryqëzim laramane, viçat e tyre deri në moshën një vjeç, si dhe rreth 60 – 70 krerë shpendë fushe dhe deti të fermerit ***, **, banor i fshatit ***, Njësia Administrative Novoselë, gjatë periudhës kohore 1993 – 2011, 3 faqe; deklaratë noteriale, nr. rep. ***, nr. kol. ***, e shtetasit ***, **, datë **.8.2020, ku si administrator i shoqërisë “*** ***” sh.p.k. deklaron se fermeri ***, ***, ka shitur dhe përpunuar pranë fabrikës së tij sasi të shumta ulliri prej vitit 1995 e në vazhdim, 3 faqe; një kopje e të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti, 1(një) faqe; deklaratë noteriale, nr. rep. ***, nr. kol. ***, e shtetasit ***, **, datë **.8.2020, ku si kasap ka blerë nga fermeri ***, **, banor i fshatit ***, viça në moshën 1(një)-vjeçare dhe gjela deti, 3 faqe; një kopje e të dhënave të QKB-së mbi regjistrimin e këtij subjekti, 4 faqe; deklaratë noteriale, nr. rep. ***, nr. kol. ***, e shtetasit ***, **, datë **.8.2020, me të cilën provohet fakti se fermeri ***, ***, ka shitur pranë fabrikës së tij sasi të shumta qumështi nga viti 1995 deri në vitin 2011, 3 faqe; deklaratë noteriale e shtetasit ***, **, nr. rep. ***, dhe nr. kol. ***, datë **.11.2022, ku provohet që të ardhurat që fitonte nga aktiviteti privat bujqësor, babai i këmbente me monedhën euro pranë pikës së këmbimit valutor “*** ***” Exchange, 6 faqe; faturat e lëshuara nga “*** ***” Exchange, mbi këmbimet e monedhave që janë kryer ndër vite nga babai, pranë kësaj pike këmbimi valutor, 3 faqe; një kopje e dosjes së pensionit të babait, ***, **, 40 faqe; një kopje e certifikatës së përbërjes familjare të datës **.8.1991, 1 faqe; shkresë nr. *** prot., datë **.11.2022, ku kërkohet informacion i shoqëruar me akte pranë Njesisë Administrative Novoselë; shkresë nr. *** prot., datë **.11.2022, me të cilën është dërguar Raporti i Vlerësimit Ekonomiko – Bujqësor, mbi të ardhurat dhe fitimin e krijuar nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i familjes së ***, **, gjatë periudhës kohore 1993 – 2016, i hartuar nga agronomi, veterineri dhe administratori i Njesisë Administrative Novoselë, pranë Bashkisë Vlorë, 6 faqe; fotografi ullinjve; Mandatarkëtimi nr. *** datë **.2.2011; Mandatarkëtimi nr. ***, datë **.5.2011; Mandatarkëtimi nr.***, datë **.5.2012; Mandatarkëtimi nr. ***, datë **.1.2012; Mandatarkëtimi nr.***, datë **.7.2013; Fletë – dalje, datë **.3.2005; Fletë – dalje, datë **.2.2006; Fletë – dalje, datë **.1.2007; Fletë – dalje, datë **.3.2008; Fletë – dalje, datë **.9.2008; Fletë – dalje, datë **.2.2009; Fletë – dalje, datë **.10.2009; Fletë – dalje, datë **.2.2010; Fletë – dalje, datë **.7.2010; Fletë regjistri për kulturën grurë, viti 1998 – 1999; Fletë regjistri për kulturën misër, viti 1998 – 1999; Fletë regjistri për kulturën jonxhë, viti 1998 – 1999; Fletë regjistri, për kulturën ullinj viti 1998 – 1999; Fletë regjistri, për kulturën misër, viti 2000 – 2001; Fletë regjistri, për kulturën grurë, viti 2000 – 2001; Fletë regjistri, për kulturën jonxhë, viti 2000 – 2001; Fletë regjistri, për kulturën ullinj, 2000 – 2001; Fletë regjistri, për kulturën grurë, viti 2002 – 2003; Fletë regjistri, për kulturën jonxhë, viti 2002 – 2003; Fletë regjistri, për kulturën ullinj, viti 2002 – 2003; Fletë regjistri, për kulturën misër, viti 2002 – 2003; Mandat arkëtimi nr.***, datë **.11.2013; Mandat arkëtimi nr.***, datë **.11.2017; Mandat arkëtimi nr.***, datë **.11.2018; Mandat arkëtimi nr.***, datë **.11.2019; Mandat arkëtimi nr.***, datë **.12.2021; Mandat arkëtimi nr. **, datë **.11.2020; Mandat pagese, datë **.12.2006; Mandat pagese, datë **.11.2006; Mandat pagese, datë **.11.2007; Mandat pagese, datë **.10.2008; Mandat pagese, datë **.11.2008; Mandat pagese, datë **.12.2009; Mandat pagese, datë **.11.2010; Mandat pagese, datë **.11.2012; Mandat pagese, datë **.10.2013; Mandat pagese, datë **.11.2013; Mandat pagese, datë **.11.2016.

13.6.7 Komisioni, deri në këtë fazë të hetimit, në analizë të dokumentacionit të administruar, për sa i përket shumës së të ardhurave deklaruar të krijuara nga të ardhurat bujqësore dhe prodhimet blegtorale, ka konstatuar se, në mungesë të ndonjë prove për të ardhurat e realizuara, raporti i vlerësimit mbi të ardhurat, mbetet një përafrim statistikor në nivel deklarativ, pasi ai duket se: (a) nuk përmban të dhëna të detajuara që tregojnë se cilat fakte ose rrethana janë shqyrtuar, vërtetuar, (b) nuk shpjegon se cilat metoda apo ekzaminime janë aplikuar, (c) nuk përmban standarde ose të dhëna zyrtare të njohura për produktivitetin/çmimet/shpenzimet e kryera të mirëmbajtjes për aktivitete të tilla që ekzistonin në atë kohë dhe që mund të jenë lehtësisht të aksesueshme nga burime të hapura, si dhe (ç) nuk referon të dhëna se ku janë bazuar hartuesit e raportit në përfundimet e tyre.

13.7 (ii) *Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishte, vreshtari, bujqësi, në vlerën 53.000 euro.* Nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë,¹⁰ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka investuar një shumë prej 50.000 euro në depozita, gjatë periudhës 2011-2012, përkatësisht në *** Bank (më parë ***), *** Bank dhe *** Bank.

13.7.1 Nga aktet në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit, të gjitha të ardhurat e deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës me burim krijimi: *të ardhura familjare nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishte, vreshtari, bujqësi*, të cilat ishin investuar në depozita në emër të subjektit (shuma 50.000 euro), së bashku me interesat e përfituara (3.514.09 euro), i ka transferuar në llogarinë e nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. ***.*** pranë *** Bank, në datën **.12.2015.

13.7.2 Nisur nga deklarimi i subjektit në DV-2011, Komisioni i ka kërkuar të sqarojë lidhur me likuiditetet në bankë dhe *cash*, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2011 ishte deklaruar shuma prej 53.000 euro si e ardhur, ndërkohë nga hetimi rezultoi se, në datën e deklarimit 14.12.2011, shuma prej 30.000 euro, ishte depozituar pranë *** Bank (më parë - ***) nga subjekti i rivlerësimit, dhe investuar në depozita bankare në emër të subjektit në vitin 2011. Ndërsa diferenca prej 20.000 euro është depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të saj, pranë *** Bank, në gusht të vitit 2012, dhe investuar në depozitë bankare pranë kësaj banke.

13.7.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e Pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Unë kam deklaruar vetëm të ardhurat e tyre dhe asnjë veprim tjetër, pasi kam menduar që depozitat ishin të verifikueshme, ndërsa pjesa tjetër prej 20.000 euro që është depozituar në vitin 2012, nuk është deklaruar prej meje si gjendje cash, pasi ishin kursime të prindërve të mi dhe jo të miat. Ato administroheshin prej prindërve të mi. Në vitin 2012 e në vazhdim kam deklaruar interesat e përfituara nga depozitat, si dhe transferimin e tyre në vitin 2015, në llogarinë e nënës time [...].*

13.7.4 Lidhur me depozitat në emër të subjektit, ILDKPKI, në procesverbalin e datës 5.12.2014, ndër të tjera, ka konstatuar se, referuar konfirmimeve bankare, rezulton se, përveç

¹⁰ Shkresë nr. prot.***, datë **.7.2022, nga *** Bank; Shkresë nr.*** prot., datë **.8.2020, nga *** Bank; Shkresë nr. *** prot., datë **.8.2020, nga *** Bank.

fshehjes së depozitave, subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme edhe asetet e deklaruar (duke iu referuar shtesës në depozitë në vitin 2012).

13.7.5 Subjekti përpara ILDKPKI-së, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Nuk mendoj se është fshehur nga ana ime kjo depozitë, për faktin se në deklaratën e dorëzuar në datën 14.12.2011, kam deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i familjes bujqësore në shumën 53.000 euro, të cilat duhej t'i deklaroja si gjendje cash në faqen 3, por gabimisht i kam deklaruar në faqen 4, te të ardhurat. Këtë vlerë më pas e kam depozituar në 3 banka të ndryshme të nivelit të dytë [...].*

13.7.6 Në analizën e kryer lidhur me likuiditetet, Komisioni ka marrë në konsideratë gjatë hetimit edhe deklarinimin si më sipër të subjektit para ILDKPKI-së, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kursimet e deklaruar kanë qenë të prindërve të saj dhe ata nuk kanë pasur detyrimin ligjor për t'i deklaruar.

13.8 *Lidhur me pasurinë garazh me sipërfaqe 23,04 m². Nga hetimi administrativ, konfirmohet se, me kontratë shitje nr. ** rep., nr. *** kol., datë **.9.2012, me palë shitëse ***, *** dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, Armida Moçka, është blerë garazhi me sip. 23,04 m², në vlerën 500.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. ZVRPP Vlorë¹¹ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Moçka, ka të regjistruar në titull pronësie pasurinë garazh, me sip. 23,04 m², nr. pasurie: ***, z. k. ***, vol. **, f. ***.*

13.8.1 Nisur nga fakti se subjekti rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën “Vetting”, si burim për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga paga dhe aktiviteti privat bujqësor i familjes bujqësore, Komisioni e ka pyetur subjektin se sa ka qenë kontributi i saj nga paga dhe sa ai nga aktiviteti bujqësor. Subjekti, ndër të tjera, në përgjigjet e Pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: [...] *Në lidhje me vlerën prej 500.000 lekë, të paguar për blerjen e garazhit, deklaroj se nga ky çmim janë paguar 3.000 (tre mijë) euro nga të ardhurat e aktivitetit privat bujqësor dhe blegtoral... Pjesa tjetër e çmimit, diferenca në shumën 85.730 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë është paguar me të ardhurat nga paga e funksionit si prokurore [...].*

13.9 Për sa më sipër, lidhur me pasuritë e deklaruar dhe të përshkruara më lart, hetimi administrativ i Komisionit evidentoi të njëjtat konstatime lidhur me deklarinimin e subjektit për pjesën takuese dhe provueshmërinë e burimit të krijimit lidhur me to, dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi: (i) dukej se familja e subjektit nuk kishte pasur mundësi financiare të investonte në shumën 50.000 euro për blerjen e apartamentit, të kursente 53.000 euro (ku 3.000 euro kanë shërbyer për blerjen e garazhit) dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; si dhe (ii) të jepte shpjegime lidhur me deklarinimin e saj për pjesën takuese 20%, në raport me regjistrimin e pasurive 100% në emër të saj.

13.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera¹², ka prapësuar se, sikurse ka deklaruar në Pyetësorin nr. 2, pjesën takuese nuk e ka saktësuar në deklaratën para fillimit të detyrës, nisur nga fakti që kur ka deklaruar për herë të parë, ka pasur në konsideratë

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë **/ 9/2017, Aneks nr. **, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Referohuni më gjerësisht prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në dosje të Komisionit, dhe vendimit f . 22-26.

konceptin e familjes bujqësore, sipas AMTP-ve dhe përbërjen familjare të vitit 1991, ku figurojnë të gjithë sipas certifikatës së vitit 1991, si dhe faktin që kjo pronë është blerë edhe me të ardhurat dhe kursimet e krijuara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore me kryefamiljar shtetasin ***, kështu që pjesa e saj takuese është 1/5 ose 20%. Subjekti, ndër të tjera, është shprehur se pjesa e saj takuese është pasqyruar qartë në Deklaratën *Vetting*, gjatë plotësimit të së cilës ka treguar kujdesin e shtuar dhe se në asnjë moment nuk ka shënuar apo deklaruar që pjesa e saj takuese është 100%.

13.11 Subjekti, për të provuar të ardhurat e përfituara nga familja e saj bujqësore, krahas dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit administrativ, ka vendosur në dispozicion të Komisionit akte të reja që i përkasin informacionit të dhënë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë. Subjekti ka shpjeguar se informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga këto institucione e ka vendosur në dispozicion të dy ekspertëve të fushës (inxhinier dhe agronom për vlerësimin e pasurive të paluajtshme) për të hartuar raport-vlerësimin tekniko-agronom-ekonomik, të cilin ka kërkuar të administrohet në cilësinë e provës dhe të vlerësohet si provë e plotë, në koherencë dhe në tërësi me provat e tjera, që ka dorëzuar pranë Komisionit dhe që janë bërë pjesë e dosjes, sikundër ka vepruar Komisioni dhe Kolegji të rasti i subjektit ***.***.¹³

13.12 Komisioni, pasi ka administruar prapësimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me deklarinimin e subjektit në Deklaratën *Vetting*, për pjesën takuese 20%, ka arsyetuar se, pavarësisht pretendimit të subjektit se ky deklarinim i referohet konceptit të familjes bujqësore, për sa kohë pasuria është regjistruar në emër të subjektit 100%, atëherë rezulton se subjekti ka kryer deklarinim të pasaktë¹⁴.

13.12.1 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për krijimin e pasurisë *apartment*, në shumën 50.000 euro, krijimin e depozitës me vlerë 50.000 euro, si dhe blerjen e garazhit, me të njëjtin burim krijimi nga të ardhurat e familjes së saj të origjinës nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, Komisioni ka konkluduar, në mënyrë të përmbledhur, se duke arsyetuar mbi dokumentacionin dhe të ardhurat e përfituara nga ullishtat, sipas llogaritjeve në raport-vlerësimin e administruar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, çmoi se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e familjes bujqësore janë në harmoni me njëra-tjetrën, por edhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, provojnë bindshëm që kjo familje ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë të ardhura nga shfrytëzimi i ullishtave.

13.12.2 Komisioni, lidhur me nivelin e provueshmërisë së të ardhurave të krijuara nga aktivitetit i familjes bujqësore ka arsyetuar se:¹⁵ [...] *Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë mbi masën reale të të ardhurave të përfituara nga shfrytëzimi i ullishtave, në çështjen objekt vlerësimi, mbahet në konsideratë fakti se pronësia e babait të subjektit të rivlerësimit për 39 rrënjë ullinj kaninjotë shekullorë, si dhe 231 rrënjë frantoil,*

¹³ Referohuni vendimit nr. 20, datë 14.6.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁴ Referohuni vendimit të Komisionit (f. 26).

¹⁵ Referohuni Vendimit të Komisionit (f. 29).

është e provuar me AMTP-të përkatëse, si dhe me informacionin e dhënë nga Njësia Administrative Novoselë [...].

13.12.3 Komisioni¹⁶ ka çmuar të drejtë qëndrimin e subjektit, sa i përket përmbushjes së kërkesave të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi nga analizimi i legjislacionit të zbatueshëm nuk evidenton dispozita ligjore, që të kategorizojnë të ardhurat nga shfrytëzimi i ullishtave, si të ardhura të tatueshme. Detyrimi që prodhuesit e produkteve bujqësore, në këtë rast kultivuesit e ullirit, kanë kundrejt organeve shtetërore, janë taksat vendore për tokën bujqësore, të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar). Për të provuar shlyerjen e taksave vendore për tokën bujqësore, subjekti ka provuar me dokumentacion që në PyetëSORIN nr. 2 se babai i saj ka paguar taksën e tokës bujqësore.

13.12.4 Në përfundim, Komisioni, për pasuritë si më sipër, ka vlerësuar se nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit. Në konkluzionin e arritur, trupi gjykues është bazuar thelbësisht në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuara para detyre, në mungesë të kontributit financiar nga subjekti, si dhe në mosevidentimin e ndonjë rrethane tjetër për deklarim të rremë, fshehje pasurie apo që të ardhurat të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme, që mund të cenonte pozitën e saj në këtë proces.

13.12.5 Komisioni ka arsyetuar se ky konkluzion parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, ku në paragrafin 96, citohet: [...].*gjykata vlerëson se, në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ish-in në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit [...].*

13.13 Komisioneri Publik, në shqyrtim të vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, çmon se subjekti i rivlerësimit në gjendjen që janë aktet, nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës dhe se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk gjen referencë në dispozitat kushtetuese e ligjore apo në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit për arsyet e trajtuara në vijim në këtë ankim.

13.14 Komisioneri Publik, nisur nga fakti që një pjesë e pasurive të deklaruara nga subjekti janë krijuar para fillimit të detyrës, duke pranuar se në rrethana të tilla parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit gjen zbatim duke referuar edhe në elemente të tilla, si: (i) *vlera e pasurisë*; (ii) *marrëdhënia dhe raporti i pjesëmarrjes në titullin e pronësisë të subjektit të rivlerësimit*; (iii) *mundësia e verifikimit të ekzistencës së mëparshme në kohë e burimeve dhe të ardhurave për krijimin e pasurisë së deklaruar*; (iv) *forma e posedimit të pasurisë (cash/sistem bankar)*; (v) *deklarimi i saktë dhe i plotë*; (vi) *mungesa e dyshimeve për fshehje të*

¹⁶ Referohuni Vendimit të Komisionit (f . 29).

pasurisë etj., sjell në vëmendje se në një interpretim të dispozitave të zbatueshme, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në jurisprudencën e tij interpreton se¹⁷, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

13.15 Komisioneri Publik, referuar elementëve të lartpërmendura, konstaton se në rastin konkret, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se në cilësinë e pjesëtares së familjes bujqësore, zotëron vetëm 20% të titullit të pronësisë, për pasurinë e paluajshme të deklaruar prej saj në përmbushje të detyrimeve ligjore: (i) “*apartament me sipërfaqe 116 m²*” dhe (ii) “*garazh me sipërfaqe 23,04 m²*”, me adresë në lagjen “****”, Vlorë, ndryshe nga sa vetë subjekti i rivlerësimit ka vepruar dhe deklaruar për likuiditetet, nuk gjejnë mbështetje në titullin e pronësisë për secilën pasuri, ku subjekti i rivlerësimit rezulton si mbajtëse e vetme e këtij titulli në masën 100%, edhe në momentin e dorëzimit të D-Vett.

13.15.1 Lidhur me ardhurat e pretenduara si burim krijimi për pasuritë e paluajshme *apartament dhe garazh*, nisur nga raporti i pronësisë që subjekti i rivlerësimit ka në titullin përkatës, Komisioneri Publik, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit¹⁸, vlerëson se provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk provojnë faktin e realizimit të këtyre të ardhurave, dhe as masën e tyre.

13.16 Referuar deklaratimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, të cilat, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në jurisprudencën e Kolegjit, shërbejnë si provë gjatë këtij procesi, në gjendjen që janë aktet, duket se subjekti i rivlerësimit mungon të provojë burimin dhe pjesën takuese të shumës prej 53.000 euro, të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, shumë e cila po ashtu deklarohet të ketë si burim të ardhurat nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale e prindërve të subjektit të rivlerësimit.

13.16.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, konstatohet se në deklaratën para fillimit të detyrës, datë 14.12.2011, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 53.000 euro, nga të cilat duket se shuma prej 23.000 euro, në interpretim të deklaratimeve të mëvonshme të subjektit të rivlerësimit, është disponuar në *cash*, dhe vetëm shuma prej 30.000 euro, dokumentohet të ketë qenë e depozituar pranë *** Bank, në emër të saj.

13.16.2 Komisioneri Publik nënvizon se në këtë rast mban në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se në interpretim të të vepruarit në cilësinë e përfaqësueses së familjes bujqësore, kjo vlerë monetare/pasuri e luajshme në tërësi, i është transferuar nënës së saj në vitin 2015, porë kjo në harmoni me faktin e vërtetuar se e gjithë vlera në fjalë, që nga momenti i depozitimit dhe gjatë procesit të rivlerësimit, nuk rezulton të jetë përdorur për krijimin e pasurive nga ana e subjektit të rivlerësimit apo familjes së saj aktuale dhe asaj të mëparshme

¹⁷ Referohuni vendimit (JR) nr. 19/2019; vendimit (JR) nr. 8/2019; vendimit (JR) nr.13/2020; vendimit (JR) nr. 12/2020 etj.

¹⁸ Referohuni vendimit (JR) nr. 33/2022 të KPA-së.

dhe/ose të ketë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tjera, pasi verifikohet ekzistenca e saj, e paprekur në sistemin bankar, sikurse deklaruar në deklaratën përkatëse vjetore, nga ana e subjektit të rivlerësimit.

13.17 Për sa më lart, lidhur me aplikimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, në funksion të shkaqeve të ankimit, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk qëndron arsyetimi i Komisionit, pasi në rastin konkret pamjaftueshmëria financiare e konstatuar, referuar dhe disa prej elementeve të përmendura më lart në këtë ankim, nuk është në masën/vlerën që të mund të gjejnë zbatim këto parime, të aplikuar deri më tani në jurisprudencën e Kolegjit, gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë. Në gjendjen që janë aktet në dosje, duket se vetëm shuma prej 3.109,689¹⁹ lekë konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit të D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, në raport me vlerën totale të pasurisë së deklaruar.

13.17.1 Komisioneri Publik vlerëson se i njëjti arsyetim vlen dhe gjen mbështetje dhe në jurisprudencën e Kolegjit²⁰, lidhur me besueshmërinë për krijimin e të ardhurave nga kultivimi i kulturave bujqësore dhe blegtorale, të cilat në gjendjen që janë aktet mbeten në nivel deklarativ dhe nuk gjejnë mbështetje të plotë në dokumentacionin e administruar.

13.18 Në përfundim, në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të tij, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

14. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret, të ligjit të zbatueshëm dhe jurisprudencës së Kolegjit;

15. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

16. Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet, ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kontrollit të pasurisë dhe për pasojë, vendimi nr. 605, datë 21.12.2022, i Komisionit, nuk konsiderohet i drejtë dhe nuk duhet lënë në fuqi;

¹⁹ Të ardhura në shumën rreth 2.400.000 lekë, sipas “Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme”, të DRSSH-së Vlorë, për periudhën 1994 - 2011, si dhe 709.689 lekë nga shpronësimi.

²⁰ Referohuni vendimit (JR) nr.18/2021 të KPA-së.

17. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4 dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

18. Komisioneri Publik kërkon, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA